

Komuna e Mitrovicës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Mitrovicës qeveriset nga koalicioni PDK-AKR. Kryetari i Komunës, nënkryetari dhe kryesuesi i Kuvendit Komunal vijnë nga PDK. Komuna e Mitrovicës ka edhe nënkryetarin për Komunitete i cili vije nga radhët e Partisë Demokratike Turke të Kosovës (KDTP).
2. Kryetari i Komunës është Avni Kastrati. Z. Kastrati është zgjedhur në këtë pozitë pas zgjedhjeve të fundit lokale më 2009,¹ pas mbajtjes së balotazhit në mes tij dhe kandidatit nga Aleanca Kosova e Re (AKR), Nexhmedin Spahiu.
3. Komuna e Mitrovicës përfshinë një territor prej 350 km² dhe ka gjithsejtë 47 fshatra² me 71.909 banorë. Nga kjo shifër, 69.497 janë shqiptarë, 647 ashkali, 528 romë, 518 turq, 416 boshnjak, 23 goran, 14 serb, 6 egjiptas, 47 të tjerë, dhe 213 të pa specifikuar.
4. Komuna e Mitrovicës që nga paslufta është e ndarë në dy pjesë, atë jugore dhe veriore. Pjesa veriore e Mitrovicës kufizohet me komunat Zveçan dhe Leposaviq, derisa pjesa jugore kufizohet me Komunën e Zubin Potok-ut. Sipas Pakos së Ahtisarit dhe legjislacionit përcjellës, në territorin e Komunës së Mitrovicës është paraparë themelimi i Komunës së Mitrovicës së Veriut e cila do të funksiononte krahas Komunës së Mitrovicës së Jugut, dhe një bordi të përbashkët të të dy komunave (secila komunë e përfaqësuar me nga 5 përfaqësues) të kryesuar nga një përfaqësues ndërkombëtar i cili do të zgjidhej nga Zyra Civile Ndërkombëtare. Me qëllim të kalimit në Komunë, në Maj

¹ Nga viti 2002 deri më 2007 Komuna e Mitrovicës është udhëhequr nga LDK, përkatësisht nga Kryetarët Faruk Spahija (2000-2005) dhe Mursel Ibrahimimi (2005-2007), pastaj nga 2007 deri më 2013 nga PDK, përkatësisht nga Kryetarët Bajram Rexhepi (2007-2009), dhe Avni Kastrati (2009-vazhdon).

² Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK), Popullsia sipas gjinisë, etnicitetit dhe vendbanimit, f. 31,32.

2012 Qeveria e Kosovës merr vendim për themelimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore (ZAMV).³

5. Sipas një hulumtimi të UNDP i publikuar më 10 dhjetor 2012, niveli më i ulët i kënaqshmërisë është regjistruar për fushën e prokurimit publik dhe tenderëve, dhe menaxhimin e buxhetit komunal.⁴ Sipas këtij hulumtimi, papunësia mbetet një prej problemeve kryesore në Komunën e Mitrovicës (56%). Qytetarët e komunës së Mitrovicës janë qytetarët më të pakënaqur me shërbimet e komunës së tyre në krahasim me komunat tjera.⁵

Problemet kryesore të Komunës së Mitrovicës

1. **Rrugë të dëmtuara nëpër qytet.** Rrugët e dëmtuara nëpër qytet janë një prej problemeve kryesore me të cilin përballen qytetarët e Mitrovicës (sidomos ngasësit e veturave). Disa nga rrugët janë të dëmtuara si pasojë e vënies së ndonjë gypi të kanalizimit dhe mos rregullimi i atij vendi pas vënies së gypit për një kohë të gjatë, dëmtimeve për shkak të vjetërisë së rrugëve, dhe dëmtimeve për shkak të punëve në ujësjellës apo kanalizim. Meqë shumë rrugë në qytetin e Mitrovicës nuk janë të emërtuara, në këtë taport rasteve të dëmtimeve të rrugëve po ju referohemi në bazë të lokaliteteve. Rruga “Ukshin Kovaqica” (që shkon në drejtim të shkollës fillore “Migjeni”), është e dëmtuar tash e sa vite si pasojë e hapjes së gropave nga shiu, dhe si pasojë e vënies së gypave të ujit, gjatë pjesës së madhe të vitit 2013. Gropa të krijuara me vite si pasojë e vjetërsisë së rrugës së asfaltuar hasen edhe pranë shkollës fillore “Migjeni”. Si pasojë e vënies së gypave, rruga “Safet Boletini” (përgjatë Qendrës së Mjekësisë Familjare në “Iliridë”) mbetet e dëmtuar për shkak të mos mbulimit të duhur të kanaleve.⁶ Përveç kësaj, edhe pse nuk ka as një vit nga rregullimi i tij, trotuari për këmbësor përgjatë një pjese të madhe të rrugës “Mbretëresha Teutë” është prishur si pasojë e rregullimit të gypave të ujit apo kanalizimit.⁷ Problemi i prishjes së rrugëve dhe trotuareve, për nevoja të shtrimit të kanalizimeve dhe ujësjellësve, është problem i cili paraqitet si pasojë e mungesës së duhur të planifikimit urban në qytetin e Mitrovicës. Sipas një studimi të Qendrës Regjionale për Mjedis, organizatë ndërkombëtare e cila merret me adresimin e çështjeve mjedisore në vendet e Evropës

³ Vendimi i Qeverisë Nr. 01/75 i datës 23.05.2012.

⁴ UNDP. Mozaiku i Kosovës 2012, shërbimet publike dhe autoritetet lokale në fokus, f. 99.

⁵ UNDP. Mozaiku i Kosovës 2012, shërbimet publike dhe autoritetet lokale në fokus, f. 13.

⁶ Vizita e hulumtuesve të GAP në terren më 10 korrik 2013.

⁷ Vizita në Komunën e Mitrovicës është realizuar më 10 korrik 2013.

Qendrore dhe Lindore⁸, të kryer në janar 2012, dëmtimi i rrugëve lokale paraqitet si problemi i tretë që kanë listuar qytetarët e anketuar në komunën e Mitrovicës.⁹

2. Mbeturinat në qytet. Në shumë zona të komunës së Mitrovicës vërehen të shpërndara mbeturinat. Po ashtu, në gjithë qytetin rrallë vërehen të vendosura shportat për hedhjen e mbeturinave. Përveç kësaj, edhe pse kontejnerët aty ku janë të vendosur, pastrohen dy herë në javë, në shumicën e vendeve përreth tyre vërehen mbeturina të shumta.¹⁰ Mbeturina përreth kontejnerëve hasen sidomos në disa lokacione në Mitrovicë: në lagjen “Driton Veliu” pranë shkollës fillore “Migjeni”, në udhëkryq ku lidhen rrugët “Mbretëresha Teutë” dhe “Ukshin Kovaqica”, dhe pranë stacionit të autobusëve. Shpeshherë këtyre kontejnerëve (sidomos atyre pranë shkollës “Migjeni”) iu vihet zjarri dhe shkaktojnë ndotje të ambientit. Për më shumë, në disa vende vërehen edhe deponi të mbeturinave, p.sh si deponia afër stadiumit të qytetit “Adem Jashari”, dhe në rrugën “Zahir Pajaziti” (afër ndërtesave mbrapa lumit “Lushta”). Mbeturinat janë evidentuar si problematikë edhe nga hulumtime të organizatave tjera. Sipas studimit të cekur më lartë të Qendrës Regjionale për Mjedis (REC), menaxhimi i mbeturinave është paraqitur si problemi i dytë më i rëndësishëm në fushën e problemeve ambientale në komunën e Mitrovicës.¹¹ Sipas UNDP, mbi 41% e të anketuarve në komunën e Mitrovicës janë të pakënaqur me nivelin e pastërtisë në qytet.¹²

3. Ndotja e ambientit. Komuna e Mitrovicës është një ndër komunat e rralla në Kosovë e cila ka të themeluar Drejtorinë për Mbrojtjen e Ambientit. Megjithatë, kjo komunë është njëra prej komunave me ambientin më të ndotur në Kosovë. Përveç mbeturinave të shumta dhe rrugëve me pluhur, ambienti në Mitrovicë ndotet edhe nga mbetjet industriale nga koha e para luftës, të cilave komuna e Mitrovicës nuk iu ka gjetur zgjidhje edhe 14 vite pas luftës. Fjala është për mbetjet industriale në lokacionin e ashtuquajtur te “Dudi Kërrshi” të deponuara si pasojë e punës së ‘shkritores’ së Trepçës në Zveçan, dhe mbetjeve në oborrin e ish fabrikës së akumulatorëve, e shndërruar në Fakultetin e Gjeoshkencave dhe Teknologjisë. Sipas hulumtimeve të REC, mbi 61% e qytetarëve të anketuar mendojnë se gjendja mjedisore në komunën e Mitrovicës është e pakënaqshme.¹³ Sipas këtij studimi, në aspektin e

⁸ Kjo Qendër është themeluar në vitin 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian, dhe Hungaria. Zyra qendrore e kësaj organizate është në Hungari, derisa zyra ndërlidhëse ka në të gjitha vendet e rajonit (nuk ceket nëse ka zyre edhe në Kosovë).

⁹ Qendra Regjionale për Mjedis, janar 2012, f. 22.

¹⁰ Komuna e Mitrovicës është vizituar më 10 korrik 2013.

¹¹ Qendra Regjionale për Mjedis, janar 2012, f. 22.

¹² UNDP. Mozaiku i Kosovës 2012, shërbimet publike dhe autoritetet lokale në fokus, f. 8.

¹³ Shpërndarja e mostrës për komunën e Mitrovicës: janë intervistuar 2800 respondent (nga pjesa jugore e qytetit), ku prej tyre 85% kanë qenë shqiptarë, dhe 15% nga radhët e minoriteteve. Më

mjedisit, pesë problemet që më së shumti shqetësojnë qytetarët e kësaj komune janë: zhurma (83.0%), mbeturinat (77.4%), rrugët e dëmtuara lokale (55.9%), cilësia e ajrit (37.3%), dhe mos mirëmbajtja e zonave të gjelbra, parqeve dhe shiritave mbrojtës (31.7%). Kur është fjala për ndotësit kryesor të mjedisit në territorin e komunës së Mitrovicës, qytetarët kanë paraqitur kanalizimin si ndotësin kryesor (76.8%), mbeturinat (66.8%) dhe trafiku (67.9%).¹⁴ Ndërsa, lidhur me tre problemet kryesore që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj, qytetarët e intervistuar kishin paraqitur zhurmën si problemin e parë (67.5%), ujërat e zeza si problemin e dytë (26.2%), dhe deponitë e mbeturinave si problemin e tretë (25.8%).¹⁵

4. Mungesa e ujit të pijes. Rreth 85% e familjeve në Komunën e Mitrovicës janë të lidhura me sistemin e ujësjellësit, por vetëm 16% e familjeve kanë furnizim të rregullt me ujë.¹⁶ Po ashtu, banorët e Mitrovicës kanë mesataren më të lartë të furnizimit me ujë përmes shisheve (17.7%) në krahasim me komunat e tjera.¹⁷ Ujësjellësi në qytetin e Mitrovicës gjendet në lagjen Shipol, në periferi të Mitrovicës (rruga në drejtim të Komunës së Skenderajt). Mbi 84% e qytetit përballet me ndërprerje të furnizimit me ujë të pijes gjatë orëve të pasdites, sidomos gjatë stinës së verës. Në shtator 2009, Komisioni Evropian ka filluar projektin për ndërtimin e fabrikës së ujit në Shipol, projekt i cili ka kushtuar rreth 16.4 milion euro dhe pritet të përfundoj në janar 2014.¹⁸ Kjo besohet se do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së tanishme nga mungesa e ujit të pijes.

5. Mbeturinat në lumin Trepça. Lumi Trepça kalon në hyrje të qytetit të Mitrovicës, pranë Fakultetit të Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë. Ky lum është i mbushur përplot me mbeturina përgjatë rrugës 2 Korriku, pranë Fakultetit të Gjeoshkencave dhe Teknologjisë. Lumi Trepça e ka burimin në Shalë të Bajgorës dhe derdhet në lumin Sitnica në Mitrovicë. Mbeturinat që ka ky lum në pjesën përgjatë Fakultetit në fjalë shkakton shqetësim për banorët e lagjes, për studentët e

tejt, mostra është ndarë në meshkuj (51%) dhe femra 49 (%), dhe në grupmosha. Qendra Regionale për Mjedis, janar 2012, f. 22.

¹⁴ Qendra Regionale për Mjedis, janar 2012, f. 24

¹⁵ Qendra Regionale për Mjedis, Janar 2012, f. 34-35.

¹⁶ UNDP. Mozaiku i Kosovës 2012, shërbimet publike dhe autoritetet lokale në fokus, f. 99.

¹⁷ Iniciativa e USAID për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI). Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale (2012). Fq.23. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf (kontrolluar së fundmi më 5 gusht 2013).

¹⁸ Kosovo Aid Management Platform. Burimi: <http://public.amp-mei.net/search/38/95/14> (kontrolluar së fundmi më 5 gusht 2013).

Fakultetit, për punëtorët e Terminalit Doganor dhe për kalimtarët tjerë.¹⁹

6. Kundërmimi i shtratit të lumit “Lushta”. Lumi “Lushta” është lum i vogël për nga shtrirja dhe gjerësia, por ka një pjesë të hapur në mes të banesave në mes të zonës “Bair” dhe rrugës “Mbretëresha Teutë” (jo larg stacionit të autobusëve). Qytetarët iu referohen këtyre vendbanimeve (banesave) si banesat te Lushta apo mbrapa “Lushtës”. Në pjesën e lumit ku është i hapur, vërehen jo më pak se pesë raste ku gypat e kanalizimit (ujërat e zeza) derdhen në lumë. Kjo është duke shkaktuar një kundërmim të padurueshëm për qytetarët që jetojnë në atë pjesë. Përveç kësaj, në lumë hidhen shumë mbeturina të cilat vetëm sa e shtojnë kundërmimin dhe pa pastërtinë. Vende të hapura me mbeturina vërehen edhe në mes të banesave në këtë pjesë.

7. Mungesa e ndriçimit publik. Mungesa e ndriçimit publik është një problem tjetër me të cilin ballafaqohen qytetarët e Mitrovicës. Ndriçimi publik mungon sidomos në lagjet periferike, p.sh. në një numër të lagjeve në “Iliridë” rrugët: “Rruga e Parisit”, “Xhevat Isufi”, “Ilaz Hyseni”, “Sherif Terstena”, “Ali Jashari”, “Zijadin Ceraja”, “Ferit Preteni”, “Mehmet Selaci”, “Fuad Barani”, “Adem Boletini”, “Jashar Boletini”, “Bajram Curri”, “Murat Haliti”, “Rifat Vidishiqi”, “Dukagjini”, “Safet Rexhepi”, pastaj rrugët në lagjen “Bair” si: “Bajram Musa”, “Selim Bislimi”, pastaj rrugët tek stadiumi “Adem Jashari”, si rruga “Ibri” dhe rruga ende e pa emërtuar prapa stadiumit që lidhet me fshatin Zhabar. Situatë e njëjtë paraqitet edhe në shumë lagje tjera brenda qytetit.

8. Rregulli në administratë dhe mbingarkesa e administratës me shërbyes civil. Sipas hulumtimeve të UNDP, qytetarët e Komunës së Mitrovicës janë qytetarët më të pakënaqur me shërbimet publike të Komunës.²⁰ Në anën tjetër, pas Komunës së Prishtinës, Komuna e Mitrovicës është një ndër komunat më të mbingarkuara me staf civil. Në fund të 2012, Komuna e Mitrovicës kishte 321 të punësuar në administratën lokale. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës për kriteret e madhësisë së administratave komunale²¹, Komuna e Mitrovicës, duke marrë parasysh numrin e popullsisë, duhet të ketë më së shumti 171 të punësuar (një shërbyes civil për 620 banorë). Çfarë do të thotë se në bazë të kësaj formule të Qeverisë, Komuna e Mitrovicës ka 150 punonjës tepriçë dhe do të duhet që në vitet në vazhdim të trajtojë këtë problematikë.

¹⁹ Vizita në terren e hulumtues të GAP më 10 korik 2013.

²⁰ UNDP. Mozaiku i Kosovës 2012, shërbimet publike dhe autoritetet lokale në fokus, f. 13.

²¹ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/46 i datës 03.12.2008. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_46-te_te_Qeverise_2008.pdf

Përkundër këtij mbi punësimi, qytetarët e Mitrovicës nuk janë të kënaqur me shërbimet administrative të komunës.

9. Faturat e papaguara të komunës. Komuna e Mitrovicës është një ndër tri komunat me borxhin më të lartë buxhetor. Borxhi komunal ka shkuar duke u rritur nga 536.380 euro më 2010, në 951.000 në 2011. Vitin 2012 Komuna e Mitrovicës e ka përmbyllur me 1.301.000 euro borxh dhe radhitet e treta pas Skenderajt (1.5 milion euro borxh) dhe Gjilanit (3.2 milion euro borxh).²² Borxhi kaq i lartë dëshmon se Komuna e Mitrovicës ka bërë shkelje të vazhdueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Sipas nenit 31.1 të këtij ligji, organizatat buxhetore janë të detyruara ti shlyejnë detyrimet ndaj kontraktuesve 30 ditë pas pranimit të faturave.²³ Hyrja në obligime financiare duke mos pasur mbulueshmëri buxhetore nga të hyrat është konsideruar si rrezik për qëndrueshmërinë financiare të Komunës edhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.²⁴ Borxhi financiar i komunës do të ndikoj në uljen e investimeve në vitet në vijim, për shkak të detyrimeve për shlyerjen e borxhit.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Parku “Fehmi e Xhevë Lladrovci”.** Ky park është rregulluar në vitet menjëherë pas luftës (1999) dhe atëherë njihej si “Parku Solana”. Pas një kohe të shkurtër, ky park është shkatërruar dhe ka qëndruar për disa vite në gjendje jo të mirë. Parku është rregulluar në vitet e fundit nga Komuna dhe tani mban emrin “Fehmi e Xhevë Lladrovci”. Parku paraqet një hapësirë të gjelbëruar, me trotuare për ecje dhe vendpushime. Ky park është shumë i frekuentuar nga qytetarët e sidomos nga ata që banojnë afër të cilët e shfrytëzojnë këtë park për rekreacion. Ky park duhet mirëmbajtur, ngase është një prej hapësirave publike të cilat pëlqehet nga qytetarët.
- 2. Hapësira sportive tek ndërtesat mbrapa lumit “Lushta”.** Komuna ka investuar në rregullimin e një hapësire sportive për banorët e ndërtesave mbrapa lumit “Lushta”. Kjo është një hapësirë mirë e rregulluar dhe shërben si hapësirë rekreacioni për banorët e asaj zone. Ky rregullim pas investimit nga Komuna e Mitrovicës duhet mirëmbajtur dhe të ndiqet me shembuj të tillë edhe në zona tjera të komunës.

²² Ministria e Financave. Raporti Vjetor Financiar 2012. Fq.68.


²³ Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 31, pika 1.

²⁴ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit të Pasqyrat Financiare të Komunës së Mitrovicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012. Qershor 2013. Fq.26.

Trendet Buxhetore në Komunën e Mitrovicës

Në vitin 2013, Komuna e Mitrovicës planifikohet t'i ketë 15.1 milionë euro buxhet, ndërsa krahasuar me vitin 2011 buxheti i kësaj komune ka pasur një rënie prej 2.6 milionë euro. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e krijimit të Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore. Krahasuar me vitin paraprak komuna ka pasur një rënie të theksueshme të hyrave vetanake prej 312 mijë euro (18%) në vitin 2012. Në vitin 2012, struktura e të hyrave vetanake është dominuar nga tatimi në pronë (74%) dhe taksa për regjistrim të automjeteve (17%). Në anën tjetër, heqja e licencave të biznesit dhe ulja e tarifave biznesore ka ndikuar që të hyrat nga këto burime të shënojnë rënie prej 41 mijë euro në vitin 2012. Në vazhdim, sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Mitrovicës ka përmyllur vitin 2012 pa arritur të arkëtoj mbi 3.8 milion euro taksa nga bizneset dhe mbi 3.5 milion euro nga tatimi në pronë.²⁵ Arkëtimi i këtyre të hyrave duhet të bëhet sa më parë, me qëllim që mos të rritet borxhi i bizneseve dhe qytetarëve. Arkëtimi i të hyrave po ashtu do të ndihmon komunën që të rris investimet dhe kualitetin e shërbimeve për qytetarë.

Figura 1. Buxheti 2013²⁶




²⁵ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Mitrovicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012. Qershor 2013. Fq.25.

²⁶ Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?mitrovice/2013#/~/mitrovice>

Në bazë të grafikomit mbi ndarjet buxhetore shohim se Pagat dhe Mëditjet kanë pasur një rënie prej gjysmë milionë euro apo 5% në vitin 2012. Në anën tjetër, rënie më e theksueshme prej 1.3 milion euro (25%) pritet të ndodhë në investimet kapitale në vitin 2013.

Figura 2. Ndarjet Buxhetore 2010-2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2014-2016, shohim se Komuna e Mitrovicës planifikon t'i rrisë të hyrat totale kryesisht nga rritja e grantit qeveritar. Në anën tjetër, përveç subvencioneve planifikohet që të gjitha shpenzimet tjera të rriten veçanërisht ato kapitale dhe pagat.

Figure 4. Korniza Afatmesme e Buxhetit 2014-2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	14.625.426	15.027.367	15.344.458
Të hyrat vetanake	2.312.436	2.381.809	2.429.445
Grantet	12.312.990	12.645.558	12.915.013
Shpenzimet Totale	14.625.466	15.027.367	15.344.458
Pagat dhe Mëditjet	8.837.078	8.936.376	9.047.252
Mallrat dhe Shërbimet	1.304.167	1.268.503	1.357.238
Shpenzimet Komunale	377.773	459.127	467.149
Subvencionet dhe Transferet	682.159	656.170	660.083
Shpenzimet Kapitale	3.424.289	3.707.191	3.812.736

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulamtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Mitrovicës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj.

Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulumtimeve më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus), DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012) dhe Qendra Regjionale për Mjedis (Regional Environment Center)-REC (Raporti i të Gjeturave nga Hulumtimi për Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, Janar 2012). Për këtë hulumtim, GAP ka bashkëpunuar edhe me organizatën lokale Rrjetin Kosovar për Informim “Mitrovicapress”.



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.